



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01 Nr. 60/01-1785/2018
Kaçanik, 24.01.2018

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 24 Janar 2018, mori këtë :

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim formohet. Komiteti për Politikë dhe Financa, i Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në përbërje 7 anëtarëve.
2. Komitetit për Politikë dhe Financa, ka këtë përbërje:

2.1. Kemal Mërseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.2. Nexhat Loku	PDK	anëtar,
2.3. Pranverë Loku-Zharku	PDK	anëtar,
2.4. _____	LVV	anëtar,
2.5. _____	LDK	anëtar,
2.6. Hajredin Luta	AAK	anëtar, dhe
2.7. Hafize Sallahi	NISMA	anëtar.
3. Komiteti për Politikë dhe Financa do të plotësohet me dy anëtarë në rubrikat e zbrazura të pikës 2 paragrafët, 2.4 dhe 2.5 nga dy subjektet politike të përcaktuara; LVV me një (1) anëtar dhe LDK me një (1) anëtar, pasi t'i japin propozimet këto dy subjekte politike.
4. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa reflekton përfaqësimin e etnitetëve politike në Kuvendin e Komunës, dhe barazinë gjinore.
5. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sipas funksionit që e ka.
6. Detyrat e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.
7. Kompensimi për punën e Komitetit për Politikë dhe Financa rregullohet me Vendim, të veçantë sipas Udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Arkivi

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kacanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-1839/2018
Kaçanik, 24.01.2018

Në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit Nr. 031./040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 /04 qershor 2008 e Republikës së Kosovës), të neneve 34.5 dhe 36 lidhur me nenet 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës 01Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008 si dhe nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 24 Janar 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2018

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2018.
2. Plani vjetor i cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban; numrin e mbledhjeve, pikat – temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit, vendi dhe ora e mbajtjes, kryesimi i mbledhjeve si dhe Buxhetin e aprovuar të kuvendit të komunës për aktivitetin e kuvendit dhe trupave punuese të tij, për vitin 2018.
3. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2018, planifikon t'i mbajë gjithsej, 12 Mbledhje të Rregullta.
4. Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës, do të mbahen sipas këtij Plani të Punës:

**PLANI I MBLEDHJEVE TË KUVENDIT
PËR VITIN 2018**

Nr.	Mbledhjet	Periudha Kohore	Vendi i mbajtjes	Ora	Rendi i Punës	Kryesimi i mbledhjeve
1	2	3	4	5	6	7
01.	Mbledhja e I	Javën e fundit të muajit janar	Katin i III Salla e KK	11:00	- Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2018; - Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja Konstituive e Kuvendit të Komunës; - Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa; - Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete; - Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018; - Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB); - Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës; - Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; - Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2017/2018; - Informatë për performancën e Komunës për vitin 2016.	Kryesuesi i KK

02.	Mbledhja e II	Javën e fundit të muajit shkurt	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I e Rregullt e Kuvendit të Komunës ; 2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017; 3. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018, 4. Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2018. 5. Propozim Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2017, në vitin 2018; 6. Informatë e Kryetarit të Komunës për gjendjen ekonomike financiare, Korrik -Dhjetor 2017; 7. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës.	--
03.	Mbledhja e III	Javën e fundit të muajit mars	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i Raportit Final Financiar të Komunës për vitin 2017; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës.	--
04.	Mbledhja e IV	Javën e fundit të muajit prill	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti Tremujor Financiar i Komunës, Janar – Mars 2018; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës,	--

05.	Mbledhja e V	Javën e fundit të muajit maj	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i ndonjë, Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës; 3. Informatë mbi Qarkoren e I (Parë) Buxhetore të Ministrisë së Financave; 4. Informatë për aktivitetin e komiteteve funksionale të kuvendit.	--
06.	Mbledhja e VI	Javën e fundit të muajit qershor	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KBAK) për vitet 2019-2021; 3. Propozim Vendimi për Rishikimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2018; 4. Shqyrtimi i Raportit (Informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendim të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 6. Informatë për realizimin e Planit të Prokurimit.	--
07.	Mbledhja e VII	Javën e dytë të muajit korrik	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VI-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti Gjashtëmuor Financiar, Janar - Qershor 2018; 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2017 ; 4. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës;	--

						5. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018;		
08.	Mbledhja e VIII	Java e fundit e muajit korrik				1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i realizimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2018; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 4. Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrije-shirjeve; 5. Informatë për aktivitetin e Zyrës për Barazi Gjinore.	--	
09.	Mbledhja e IX	Javën e fundit të muajit shtator	--	11:00		1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2019; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2019; 4. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 5. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2018/2019.	--	
10.	Mbledhja e X	Javën e fundit të muajit tetor	--	11:00		1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës, Korrik – Shtator 2018; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 4. Informatë mbi zbatimin e Ligjit kundër duhanit në territorin e Komunës së Kaçanikut.	--	

11.	Mbledhja e XI	Javën e fundit të muajit nëntor	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregullloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 3. Informatë e DUKMM për procesin e legalizimit të objekteve të ndërtimit; 4. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi gjendjen e përgjithshme të komunës; 5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë për të mbjellat vjeshtore.	--
12.	Mbledhja e XII	Java e fundit e muajit dhjetor	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XI e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 4. Informatë e KKS B për aktivitetin e zhvilluar. 5. Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2019; 6. Informatë për funksionimin e këshillave lokale.	--

4. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës caktohen nga Kryesuesi i Kuvendit, në konsultim me Kryetarin e Komunës.

4.1. Minimumi i mbledhjeve të Rregullta të Kuvendit të Komunës për një vit kalendarik është 10 Mbledhje të Rregullta, prej tyre se paku 5 Mbledhje të Rregullta duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik.

4.2. Maksimumi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës me karakter pune, me pagesë për një vit kalendarik është 12 Mbledhje.

5. Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2018, i ka paraparë me Planin e Punës me i mbajtur gjithsej 12 Mbledhje me pagesë, përcaktuar si në nenin 8.2 e Udhëzimit Administrativ 16/2008-Për kompensimin e stafit politik në komuna.

5.1. Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera më shumë se 12 Mbledhje të rregullta, por nga mbledhja e 13 të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës me karakter pune, e rregullt apo jo e rregullt, do të jenë pa pagesë.

5.2. Buxheti i aprovuar për Kuvendin e Komunës për vitin 2018 është: **92,202.00 €** nga Granti Qeveritar, Për Paga dhe Mëditje dhe Për Mallra dhe Shërbime;

5.3. Shpenzimet: Për Paga dhe Mëditje, **86,202.00 €**, përfshijnë ;

5.3.1. Paga mujore e Kryesuesit të Kuvendit për 12 muaj,

5.3.2. Paushall mujor për 26 anëtarë të Kuvendit të Komunës nga 100€, për 12 muaj,

5.3.3. Kompensimi i mëditjeve për 12 Mbledhje të Kuvendit nga 125€, për 26 anëtarë të Kuvendit, për pjesëmarrje në mbledhje,

5.3.4. Kompensimi i mëditjeve për 12 Mbledhje të KPF për 6 anëtarë nga 50€, për pjesëmarrje në mbledhje,

5.3.5. Kompensimi i mëditjeve për 4 Mbledhje të Komitetit për Komunitete për 5 anëtarë nga 50€, për pjesëmarrje në mbledhje,

5.3.6. Kompensimi për një Komitet tjetër të Kuvendit të Komunës, për 5 anëtarë për 4 mbledhje nga 50 €, për pjesëmarrje në mbledhje,

5.3.7. Nëse mungon anëtari në mbledhje të Kuvendit apo të Komiteteve, i hiqet komplet kompensimi, pavarësisht mungon me arsye apo pa arsye, sipas Udhëzimit Administrativ 16/2008 -Për kompensimin e stafit politik në komuna.

5.4. Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime janë në shumë **6,000.00€** të miratuara me Buxhetin e Komunës të vitit 2018, ku përfshihen:

5.4.1. Shpenzime të furnizimit për zyre dhe blerje tjera mallra e shërbime;

5.4.2. Shpenzime për dreka zyrtare, ku përfshihen: Shpenzimet e bufesë për Zyrën e Kryesuesit, Shpenzimet për Ujë dhe Pije për Mbledhje të Kuvendit dhe Komitete të Kuvendit, Shpenzimet për Debatin Publik të organizuar me qytetarë të komunës, për buxhetin e komunës për vitin 2019 dhe Projektionet për vitin 2020-2021 (ujë dhe pije), organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit,

5.4.3. Shpenzime; udhëtime zyrtare jashtë vendit, informimit publik, marketing, botime e publikime dhe shpenzime të përfaqësimit.

6. Të gjitha mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen vetëm ditëve të punës.

6.1. Materialet që i adresohen Kuvendit të Komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të KPF-a, dhe të

njëjtat, me Rekomandim të KPF-a i kalojnë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

- 6.1. Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike.
 - 6.2. Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
 - 6.3. Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
7. Ky Plan Pune i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, është Plan orientues edhe për mbledhjet e KPF-a, të cilat mbledhje do të mbahen se paku 3 ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, me të gjitha pikat e propozuara, me përjashtim të Procesverbalit të mbledhjeve të Kuvendit.
 8. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë Dëgjim Publik me qytetarë, për Propozim-Buxhetin e komunës për vitin 2019 dhe Projektionet për vitet: 2020-2021, para se të aprovohet buxheti në kuvend.
 9. Të gjitha mbledhjet e Rregullta të KK do të jenë hapura për: qytetarë, media dhe për çdo të interesuar tjetër.
 - 9.1. Nëse ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura, atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës.
 - 9.2. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarë të komunës, mediat dhe të interesuar të tjerë, në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.
 11. Kuvendi i Komunës për gjatë muajit gusht, do të jetë në Pushim Vjetor.
 - 11.1. Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, Kuvendi i Komunës do të njoftohet paraprakisht.
 - 11.2. Për gjatë pushimit nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mbledhet Kuvendi i Komunës.
 12. Plani i përcaktuar i Kuvendit të Komunës për vitin 2018, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime varësisht nga kërkesat dhe nevojat që paraqiten.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 104/02-1881/2018
Kaçanik, 24.01.2018

Në bazë të nenit 17 lidhur me nenin 40.2(d) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 2.1, 6.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 24 Janar 2018, merr këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2018

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018, i propozuar nga Kryetari i Komunës.
2. Në Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës janë paraqitur; synimet dhe objektivat e Kryetarit të Komunës, Drejtorive komunale, dhe forma e realizimit të tyre.
3. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës përmban numër të protokollit 01Nr. 104/02-1881/2018, është përmbledhur në gjithsej 69 faqe, dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Planit të Punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2018, do të kujdesen: Kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive përkatëse komunale.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoritë Komunale ;dhe
3. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

01Nr. Nr.400/01-1823/18
Kaçanik, 24.01.2018

Në mbështetje të nenit 12. 2 (d) lidhur me nenin 17 shkronjat: (n), (r) dhe (s) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisje Lokale, të Rregullores Nr. 05-39427/16 e datës 21 Dhjetor 2016- Për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nenit 40 pika 4 e Ligjit për Arsim Para-Universitar Nr.04 L\ 047 të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 24 Janar 2018, mori këtë:

VENDIM

Lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të DAK të parapara me Buxhetin 2018

1. Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë prej **48,190.00 €**, për realizimin e aktiviteteve arsimore, si në vijim:
 - 1.1. Aktivitete jashtë mësimore të Drejtorisë së Arsimit ;
 - 1.2. Transporti i nxënësve të shkollave fillore, të shkollave të mesme, rastet sociale, dhe nxënësve me nevoja speciale;
 - 1.3. Bursa për studentë.
2. Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë prej **47,000.00 €**, për realizimin e aktiviteteve kulturore, si në vijim:
 - 2.1. Aktivitetet kulturore;
 - 2.2. Subvencionimi i Shoqërive Kulturo-Artistike, Klubet sportive dhe OJQ-ve .
3. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Arsimit, përkatësisht nga kategoria buxhetore e Subvencioneve dhe Transfereve.
4. Mjetet buxhetore nga pika 2. e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor – Shërbime Kulturore, përkatësisht nga kategoria buxhetore e Subvencioneve dhe Transfereve.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.
7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është, Projekt - Plani i shpenzimeve buxhetore për aktivitetet e DAK-së, financimin e SHKA-ve dhe Klubeve sportive për vitin 2018 dhe koston e transportit për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, si dhe atyre me nevoja speciale.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillimit dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Drejtoria e Arsimit
Aktivitete Arsimore

04Nr.zyrtar Dt.16.01.2018



Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik
Municipality of Kaçanik

PROJEKT- PLANI I SHPENZIMEVE NË KATEGORINË BUXHETORE SUBVENCIONE

VITI 2018

Nr.	Emertimi i projektit	Shuma
	-I-	
Aktivitetet jashtë mësimore me nxënës:		
	Olimpiada Matematike e Kosovës	318.00
	-Ushqim dhe pije per nxenes – $12 \times 1.5\text{€} = 18\text{€}$	18.00
	-Transporti I nxenesve- $12 \times 20\text{€} = 240\text{€}$	240.00
	-Pagesa e hartuesit te testeve dhe komisionit –	60.00
	Gjuhëtari I Ri 2014	232.50
	-Ushqim dhe pije per nxenes – $35 \times 1.5\text{€} = 52.50\text{€}$	52.50
	-Transporti I nxenesve $12 \times 10\text{€} = 120.00\text{€}$	120.00
	-Pagesa e hartuesit te testeve dhe komisionit – $3 \times 20\text{€} = 60\text{€}$	60.00
	Garat Komunale te Diturisë (në 7 Lëndë)	704.00
	Ushqim dhe pije per nxenes $216 \times 1.5\text{€}$	324.00
	--Transporti I nxenesve- $12 \times 20\text{€} = 240.00\text{€}$	240.00
	--Pagesa e hartuesit te testeve dhe komisionit – $7 \times 20\text{€} = 140.00\text{€}$	140.00
	Testi Arritshmerisë per kl.IX-ta dhe Testi Maturës 2014	1,350.00
	Ushqim dhe pije per adiministruesit e testit – 450.00€	450.00
	Pije për nxënësit (UJE)	900.00
	Udhëtime të ndryshme të	1,000.00
	TOTALI	3,604.50

II

TRANSPORTI I NXËNËSVE

1	Pagesa e Transportit të nxënësve me nevoja speciale Kaçanik-	2,700.00
2	Subvencione për nxënës me nevoja speciale për raste të	1,950.00
3	Pagesa e Transportit të nxënësve të Shkollave Fillore të	9,435.50

4	Pagesa e transportit të nxënësve të Shkollave të Mesme të	20,000.00
5	Transporte tjera të nxënësve	500.00
	TOTALI	34,585.50

III

Bursa për studentë		
1	Bursa për studentë për vitin shkollor 2016/17	10,000.00
	TOTALI	10,000.00

	TOTALI I+II+III	48,190.00
--	------------------------	------------------



Drejtori / Drejtorisë

Zahir Doda



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Drejtoria e Arsimit

Aktivitetet Kulturore

04Nr.zyrtar Dt.16.01.2018



Komuna Kaçanik
Opstina Kacanik
Municipality of Kacanik

PROJEKT- PLANI I SHPENZIMEVE NË KATEGORINË BUXHETORE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE PËR AKTIVITETE KULTUROR E SPORTIVE

VITI 2018

Nr.	Emertimi i projektit	Shuma
	-I-	
	Aktivitetet kulturore	
1	Pavarësia Kosovës	1,100.00
	Akademia,aktivitete kulturore, ftesa dhe njoftime, skena.	600.00
	Turneu në Futboll	500.00
2	5,6,7,8 Marsi-Epopeja e UÇK-së, Dita e mësuesit,Dita e gruas	50.00
3	Turneu Ndërkombëtar i Shahut “ Reshat Shehu “	800.00
4	1 Qershori -Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe e Viktimave të Pafajshme të Agresionit	200.00
	Koncert për fëmijë	100.00
	Lojëra të ndryshme, shfaqje	100.00
5	11 Qershori-Dita e Çlirimit të Kaçanikut	6,500.00
	Fetivali tradicional i SHKA-ve -	6,500.00
6	Koncert më moton” Mirë se vini mërgimtarë”	1,000.00
7	10 Gushti -Dita e Dëshmorëve të Kaçanikut	350.00
	Aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive	200.00
	Akademi përkujtimore	150.00
8	Dita e Rinisë	250
	Aktivitete rinore,kulturore dhe sportive	250

9	Festat e nëntorit	500
	Akademi	250
	Koncert,shfaqje,aktivitete sportive,defile	250
10	Dita e personave me aftësi të kufizuara-3 dhjetori	200.00
11	Zgjedhja e sportistit të vitit	350.00
	TOTALI I AKTIVITETE KULTURORE	11,300.00

-II-

Subvencionimet për Shoqëritë kulturore artistike dhe Klubeve Sportive (Të cilat do të aplikojnë me projekte sipas rregullorës Nr. 06/2016 të miratuar nga Kuvendi komunal)

1	FUTBOLL – Klubet Publike Seniore të regjistruara pranë DAK që garojnë në Superligë, Ligën e parë dhe të dytë të Kosovës	17,800 €
2	BASKETBOLL – Klubet Publike Seniore të regjistruara pranë DAK që garojnë në Superligë, Ligën e parë dhe të dytë të Kosovës	3,500 €
3	HENDBOLL- Klubet Publike Seniore të regjistruara pranë DAK që garojnë në Superligë, Ligën e parë dhe të dytë të Kosovës	3,500 €
4	VOLEJBOLL - Klubet Publike Seniore të regjistruara pranë DAK që garojnë në Superligë, Ligën e parë dhe të dytë të Kosovës	2,000 €
5	MUNDJE – Klubet sportive publike të regjistruara pranë DAK që garojnë në nivel garash mbrenda dhe jashtë vendit	1,000 €
6	TAEK-WONDO- Klubet sportive publike të regjistruara pranë DAK që garojnë në nivel garash mbrenda dhe jashtë vendit	700 €
7	SHAHU - Klubet Publike Seniore të regjistruara pranë DAK që garojnë në Superligë, Ligën e parë dhe të dytë të Kosovës	800 €
8	Organizatrat sportive të regjistruara pranë DAK që mirren me organizimin e garave sportive shkollore (shkollat fillore dhe të mesme)	500 €
9	Organizatrat sportive të regjistruara pranë DAK që mirren me rekreacion dhe alpinizëm	700 €
10	Organizatrat kulturore të regjistruara pranë DAK që mirren me promovimin , ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore	4,000 €
11	Organizatrat rinore të regjistruara pranë DAK që mirren me promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe punën vullnetarë të të rinjëve	1,200 €

	Shuma e përgjithshme e grantit për subvencionime	35,700 €
	TOTALI I SHUMËS PËR SUBVENCIONIMIN E SHKA-VE DHE KLUBEVE SPORTIVE	35,700.00
	TOTALI I+II	47,000.00



Drejtori I Drejtorisë
Zahir Doda

[Signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal off Kačanik

01Nr. 08-400/01-1466/18
Kaçanik, 24.01.2018

Në bazë të nenit 17 (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 06/L-020, të nenit 6.2 dhe 61.1 të Statutit të Komunës të Komunës, të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400/01-29953/17 - të Buxhetit të Komunës për vitin 2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 24 Janar 2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR DESTINIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË DREJTORISË SË BZHRP TË PARAPARA ME BUXHETIN E VITIT 2018

1. Me këtë Vendim, buxheti i lejuar për vitin 2018 nga mjetet e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë **60.000.00 €** (Gjashtëdhjetëmijë euro) me destinim për realizimin e projekteve të drejtorisë së Bujqësisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, shpërndahet për këto projekte:

1.1. Projekti për mbështetje të bletarëve me koshere të bletëve, në shumë: **15.000.00 €**;

1.2. Projekti për mbështetje të fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m², në shumë **25.000.00 €**;

1.3. Projekti për subvencionimin e fermerëve me farë gruri dhe pleh mineral, shuma e mjeteve: **20.000.00 €**.

2. Obligohet drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë t'i merr veprimet e nevojshme për implementimin e projekteve, sipas projekteve të detajuara të cilat gjenden në këtë drejtori.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen : drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë dhe drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.

4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
3. Drejtorja e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës

01-08Nr. 400/01-1466/18
Kaçanik, 11.01.2018

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, bazuar në Ligjin mbi Buxhetin e RKS Nr. 03 L-001, nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës dhe Vendimit të Kuvendit Komunal 01-Nr. 400/01-29953/17 mbi miratimin e Buxhetit për vitin 2018

PROPOZON

Që Kuvendi Komunal në bazë të nenit 17 (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 6.2 dhe 61.1 të Statutit të komunës të merr :

V E N D I M

PËR DESTINIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË DREJTORISË SË BZHRP-së TË PARAPARA ME BUXHETIN E VITIT 2018

I.

Buxheti i lejuar nga mjetet për subvencione dhe transfere prej **60,000.00 €**, të shpërndahet për këto projekte :

Projekti për mbështetje e bletarëve me koshere të bleteve, **shuma e mjeteve 15,000.00 €**

Projekti për mbështetje të fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50 m², **shuma e mjeteve 25,000.00 €**.

Projekti për subvencionim të fermerëve me farë gruri dhe pleh mineral, **shuma e mjeteve 20,000.00 €**

II.

Obligohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë që të bëjë implementimin e projekteve sipas projekteve detaje të cilat gjenden në drejtori.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

V.

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.

Arsy et i m

Realizimi i këtyre projekteve, fermerëve iu krijon lehtësira në uljen e kostos së shpenzimeve për prodhimet e tyre.

Projekti për mbështetje të fermerëve për mbjelljen e kulturës së grurit, do të jetë i një rëndësie të veçantë ngase kultivimi i kësaj kulture ka kosto të lartë shpenzuese për prodhim, kjo është një kulturë strategjike që duhet trajtim i veçantë nga të gjitha kulturat tjera bujqësore.

Projekti për mbështetje të fermerëve me serra do të jetë e rëndësishme për rritjen e rendimentit të kulturave perimore për njësi të sipërfaqes dhe daljen e tyre më herët në treg.

Projekti për mbështetje e bletarëve me koshere të bletëve do të ndikoj në rritjen e interesimit të bletarëve egjistues për shtimin e numrit të shoqërive të bletëve dhe uljen e kostos së prodhimit.

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

